



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:250626
Datë: 08.12.2023
Numri i dokumentit: 05037842

C-IV.-14-5663

Ankuesi:

M S nga f.sh G e E K.Lipjan.

Kundër:

E paditura:

N.SH “Seperacioni i Gurëve” – Gadime, të cilën e përfaqëson **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me dt.04 dhjetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

1.HEDHET poshtë si e papranueshme ankesa e ankuesit, kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN051-0158 dt.03 korrik 2014.

2.Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.29 korrik 2014, ankuesi ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr. PRN051-0158 dt.03 korrik 2014 për kompensim të pagave të pa paguara nga NSH “Seperacioni i Gurëve” (në likuidim). Ka pohuar se AL ia ka refuzuar ankesën pa kurrfarë

baze juridike, kërkesa e tij nuk është parashkruar dhe se është zbatuar gabimisht e drejta materiale. Ankesës nuk i ka bashkangjitur kopjen e vendimit të atakuar.

Me urdhrin e dt.26 korrik 2023, gjykata ka kërkuar nga ankuesi që të bëjë dorëzimin e kopjes së Vendimit të kundërshtuar si dhe prova të tjera shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore. Ankuesi e ka pranuar urdhrin me dt.30 gusht 2023, por deri në kohën e përpilimit të këtij vendimi nuk i është përgjigjur të njëjtit.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit hedhet poshtë si e papranueshme.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 74.2, i Ligjit për Dhomën e Posaçme, përcakton: *Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendimi i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankesa duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2. të nenit 27 të kësaj shtojce dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi.*

Nenet 33 dhe 35, të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ndër të tjera rregullojnë parashtrimin e kërkesave përkatësisht ankesave dhe nisjen e procedurave në Dhomën e Posaçme. Neni 35.2 më tej përcakton se çfarë duhet të përmbaj një kërkesë apo ankesë.

Neni 36.2.2.5, i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh që: *Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse: kërkesa/ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 të kësaj shtojce dhe është në përputhje me dispozitat e nenit 35 të kësaj shtojce.*

Neni 36.2.2.6 i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh që: *Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse: është bashkëlidhur edhe një kopje e aktit juridik kundër apo ndaj të cilit është paraqitur kërkesa/ankesa.*

Një rregullim të njëjtë ishte paraparë edhe me shtojcën e Ligjit Nr.04-L-033 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përkatësisht në nenet 25, 27, 28 dhe 70.2 të të njëjtit ligj, i cili ka qenë në fuqi në kohën e parashtrimin të ankesës.

Në kuptim të këtyre dispozitave, gjykata vjen në përfundim se ankesa duhet të dorëzohet në gjykatë së bashku me vendimin e atakuar të Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit 30 ditor pas pranimit të vendimit. Në këtë mënyrë, dorëzimi i vendimit të atakuar nga ankuesi është një kriter i provueshmërisë së ankesës përkatësisht mosdorëzimi i këtij vendimi nga vet ankuesi, e bën ankesën e tij të papranueshme.

Megjithatë, gjykata i ofroi edhe një mundësi ankuesit për ta plotësuar këtë kusht të pranueshmërisë, ashtu që nëpërmjet urdhërit të datës 26 korrik 2023, i kërkoi dorëzimin e vendimit të atakuar të Autoritetit të Likuidimit dhe prova shtesë, brenda afatit të përcaktuar. Urdhri është pranuar nga ankuesi me dt.30 gusht 2023, por deri në kohën e përpilimit të këtij vendimi nuk i është përgjigjur të njëjtit.

Pra, meqenëse ankuesi dështoi në përmbushjen e kërkesës sipas urdhrit të gjykatës për të dorëzuar kopjen e Vendimit të kundërshtuar të Autoritetit të Likuidimit dhe provave shtesë deri në datën e marrje së vendimit, gjykata vendosi të hedh poshtë ankesën e tij si të papranueshme.

Për këtë në pajtim me nenet 36.1, 36.3 dhe 74.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, Ankesa kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, hedhet poshtë si e papranueshme.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a
Hajrie Shala